



Botschaft
der Bundesrepublik Deutschland
Pristina

Shpallje për vitin 2018: Përkrahje për projektet e vogla në kuadër të bashkëpunimit teknik

Qëllimi i përkrahjes:

- ndihmë fleksibile, e shpejtë dhe efektive
- realizim i nevojave bazike për shtresat e varfëra dhe shumë të varfëra të popullsisë

Projektet që përkrahen janë ato, të cilat:

- **nuk mund të vetëfinancohen** nga bartësit vendor (p.sh. organizatat joqeveritare ose grupet vetëndihmëse);
- përmbajnë vetëfinancim të pjesshëm nga bartësi i projektit, nxisin bashkëpunimin e popullsisë dhe kanë **ndikim afatgjatë**;
- nuk e tejkalojnë **shumën e mbështetjes** prej 8.000,-€;
- janë planifikuar ashtu që **të mos kenë shpenzime për personel**;
- nuk krijojnë obligime recidive (p.sh. për nevoja të vazhdueshme për mallra konsumuese siç janë karburantet, ushqimet për kafshë, barnat, materialet e ndryshme etj.);
- ju kontribuojnë sa më shumë njerëzve;
- mund të realizohen brenda vitit kalendarik 2018.

Nuk përkrahen individë ose ndërmarrje. Start-up bizneset janë gjithashtu të përjashtuara nga mundësia e mbështetjes financiare.

Procedura

Projektpropozimet duhet të dorëzohen me shkrim ose nëpërmjet email-it në ambasadën gjermane dhe duhet të përmbajnë të dhënat vijuese:

Në aplikacion duhet të shënohen:

- Bartësi i projektit
- Qëllimi i projektit
- Target-grupet
- Masat e planifikuara dhe ndikimi i tyre në target-grupe

Aplikacioni duhet të nënshkruhet nga dy persona që janë përgjegjes për projektin (nëse aplikacioni dorëzohet nëpërmjet email-it, nënshkrimet duhet të skanohen).

Veç kësaj duhet të dorëzohen edhe këto dokumente shtesë:

- Financimi i projektit (vetëfinancimi, financimi nga palët e treta, mbështetja financiare e kërkuar e kërkuar nga ambasada) në formë tabelare dhe me shenime për shpenzimet përkatëse
- Dy paralogaritje të shpenzimeve (oferta për materialin dhe shpenzimet e punës për realizimin e projektit, të përkthyer në gjuhën gjermane ose angleze)
- Kopje e ekstraktit nga regjistri përkatës kosovar

Formularët e aplikimit për projekte mund t'i gjeni në faqen e internetit të ambasadës gjermane. Ju lusim të dorëzoni aplikimet tuaja **në gjuhën gjermane ose angleze** së bashku me gjithë dokumentacionin e kërkuar dhe nënshkrimet e dy personave përgjegjës të projektit deri më **30 mars 2018**.

Në bazë të listës së bashkëngjitur të kontrollit ju mund të vlerësoni nëse i përmbushni kriteret dhe nëse kërkesa juaj është plotësuar në menyre të mirëfilltë. Një listë kontrolli e plotësuar teresisht (ku të gjitha pyetjet janë të përgjigjura me PO) nuk ju garanton se projektpropozimi i juaj do të aprovohet.

Shqyrtimi i projektit bëhet nga ambasada gjermane. Pas vlerësimit dhe aprovimit të projektpropozimit, së bashku me bartësit e projektit, do të lidhet nje kontratë mbështetëse.

Me këtë kontratë mbështetëse rregullohen të drejtat relevante si dhe obligimet. Bartësi i projektit obligohet të jap llogari të hollësishme lidhur me mjetet e alokuara, të dorëzojë faturat origjinale me përkthime përkatëse. Veç kësaj, bartësi i projektit pranon që projekti publikisht të promovohet nga ambasada.

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni seksionin për bashkëpunim ekonomik dhe zhvillim pranë ambasadës gjermane në Prishtinë. Ju lusim të mos parashtroni pyetje shtesë për çështjet që janë të sqaruara në këtë fletëinformacion. Për shkak të numrit të lartë të aplikuesve nuk mund të ofrohet këshillim individual.

Kontakti:

Ambasada Gjermane në Prishtinë

Seksioni për Ekonomi dhe Bashkëpunim Ekonomik

Rr. Azem Jashanica Nr. 66, Dragodan II

10 000 Prishtinë

TEL: +381 (0)38 2545-00

FAX: +381 (0)38 2545-36

E-Mail: info@pris.diplo.de